

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

27.09.2024

Ora, 11:52

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|---------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Madalena Koja |

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme kemi për shqyrtim një projektakt të propozuar nga një anëtar i Komisionit Rregullator. Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Rregullator”. Projekti ka ardhur me kërkesë të një anëtari, konkretisht nga unë që e kam bërë propozimin zyrtar. Sipas Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator vetëmbledhet në raste të caktuara me kërkesë të një anëtari. Ky projektakt ka ardhur në këtë moment pasi jemi para një procesi të pritshëm zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 dhe po e fillojmë me vendimin për miratimin e rregullores sonë për të saktësuar, propozimi pra, konsiston në saktësimin e disa proceseve gjatë organizimit të mbledhjes së Komisionit Rregullator. Para se të fillojmë me diskutimin e projektaktit do të pyesja kolegët, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë? Nuk ka çështje jashtë rendit të ditës! Meqenëse propozimi vjen nga një anëtar atëherë, po relatoj unë lidhur me përmbajtjen e projektaktit.

Me vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar rregulloren për organizimin dhe funksionimin e e tij. Projektvendimi që propozohet përcakton disa ndryshime të rregullores. Është projektvendim i natyrës normative dhe propozohen disa ndryshime nga titulli dhe disa shtesa e ndryshime në nenet e rregullores. Kolegë, dëshironi që ta lexoj të gjithë relacionin e përgatitur, apo në përmbajtje do të duhet t’i diskutojmë gjatë shqyrtimit dhe miratimit nen për nen, apo pikë për pikë? Nëse dëshironi, unë po vazhdoj.

Në nenin 5, janë propozuar të bëhen këto ndryshime:

Shkronja “c” e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

c) Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa për njoftimin e mbledhjes dhe dërgimin e materialeve të mbledhjes tek anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e partive politike parlamentare, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe personat e tretë sipas rastit.

Në pikën 2, shkronja “a” që do t’i referohemi rregullores, bën fjalë për të drejtat e anëtarëve dhe kryetarit të Komisionit Rregullator, është propozuar të ndryshohet si më poshtë:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

a) T'i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje, si dhe t'i lërë detyra sipas nevojave administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin t'u përgjigjet kërkesave dhe të vërë në dispozicion kopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës.

Po në pikën 2, pas shkronjës "b" është propozuar të shtohet një shkronjë tjetër b/1 me këtë përmbajtje:

b/1. Të kërkojë praninë në mbledhjet e Rregullatorit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara, ose të angazhuara dhe me përvojë në fushën e zgjedhjeve si dhe çdo subjekt që ka interes të ligjshëm për projektaktin që shqyrtohet.

Në nenin 7 propozohen ndryshimet si më poshtë:

7. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ.

Në aktin që kemi në fuqi ishte "Rregullatori", pra kërkohet mbështetje dhe asistencë nga kryetari dhe çdo anëtar.


Neni 17, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

3. Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet.

Një ndryshim, si propozuese mendoj se është forma e aktit. Duke qenë se jemi para akteve normative që na ka ngarkuar Kodi Zgjedhor për të miratuar, është propozuar të rregullohet dhe forma e aktit e cila në nenin 33 që propozohet të ndryshohet përmbajtja e tij, parashikon:

- Stemën e Republikës së Shqipërisë;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

- Emrin e institucionit;
- Logon e institucionit;
- Emrin e organit që nxjerr aktin;
- Titullin e aktit;
- Preambulën e aktit ku përfshihen dispozitat e kompetencës së nxjerrjes së aktit, dispozitat autorizuese për nxjerrjen e aktit si dhe propozuesi i aktit;
- Përmbajtjen e aktit; le të themi përmbajtjen normative.
- Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje;
- Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër);
- Numrin, datën dhe orën e miratimit.

Gjithashtu është riformuluar edhe pika 2 e të njejtit nen.

Pika 2. “Akti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, pasi të kenë verifikuar përmbushjen e vullnetit të tyre të shprehur me votë”.


Ky propozim është bërë për të shmangur problematikat që mund të jenë vënë re gjatë veprimtarisë katër-vjeçare të Rregullatorit.

Është propozuar që:

Pika 2 e nenit 34 të shfuqizohet. Kjo vjen si pasojë e riformulimit të nenit 33 për formën e aktit. Duke qenë se ky akt është kompetencë e Komisionit Rregullator, është dërguar zyrtarisht pranë anëtarëve të Komisionit Rregullator. Është dërguar zyrtarisht Komisionerit dhe administratës. Meqenëse jemi në këtë pikë, nga ana e administratës, nga ana e Drejtorisë së Ligjshmërisë, zonja Koja keni diçka paraprakisht, përpara se ne të fillojmë me diskutimin në parim?

Znj. M. Koja: Jo nuk kemi ndonjë gjë konkrete.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Znj. I. Nano: Faleminderit! Atëherë kolegë, fillojmë me diskutimin në parim të projektvendimit. Kush dëshiron fjalën? Nuk kemi diskutime në parim! Kalojmë në votimin në parim të projektaktit!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Me pesë vota pro miratohet!

Kalojmë pikë për pikë. Me propozimin e një anëtari, Komisioni Rregullator vendosi: Kreu I. Në vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Titulli i vendimit ndryshon si më poshtë:

“Për miratimin e Rregullore së mbledhjeve të Komisionit Rregullator”.

2. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Miratimin e Rregullore së mbledhjeve të Komisionit Rregullator, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Thjesht më lejoni si propozuese, këtu është përputhur titulli i vendimit dhe teksti në projektakt me Kodin Zgjedhor, pasi në vitin 2020 është miratuar Rregullore për organizimin dhe funksionimin, Kodi Zgjedhor parashikon “Rregulloren e mbledhjeve”. Kolegë për këtë, Kreun I kemi diskutime? Nuk ka. Kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kalojmë në Kreun II. Në tekstin e Rregullore, miratuar me vendimin nr. 1, datë 26.10.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Ndryshimi i parë, në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

a. Shkronja “c” e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

“c) Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa për njoftimin e mbledhjes dhe dërgimin e materialeve të mbledhjes tek anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësuesit e partive parlamentare, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore dhe personat e tretë sipas rastit.

b. Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

Apo ti kalojmë një nga një?

Znj. H. Vukaj: Meqenëse janë ndryshime të reja të kalohen me votim secila pikë.

Znj. I. Nano: Dakord. Atëherë kemi të parën. Ndryshimet në shkronjën “c”.

Kemi diçka kolegë? nuk ka! Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S’ka!

Me pesë vota pro miratohet!


b. Shkronja “a” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“a) t’i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje, si dhe t’i lërë detyra sipas nevojave administratës së KQZ-së, e cila ka detyrimin t’u përgjigjet kërkesave dhe të vërë në dispozicion kopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës.

Kolegë, kemi diçka? Po dakord, edhe zoti Çela. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në funksion të gjithë dinamikës së pasur dhe në përshtatje të nevojave, por dhe veprimtarisë në raport me detyrimet që ka administrata ndaj

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Komisionit Rregullator dhe anëtarëve të saj, unë gjej me vend në këtë pikë të bëj një shtesë në fund të këtij paragrafi, ku të shtojmë edhe raportimin për zbatimin e çdo detyre të lënë, kërkesë të angazhuar, apo informacioni që mund të kemi kërkuar gjatë mbledhjeve. Gjatë kësaj periudhe katër-vjeçare na ka kërkuar pa dyshim angazhim dhe konsistencë e rregullt e administratës, por hera-herës, kemi pasur edhe ne zhgënjimet tona në raport me detyrat e lëna, apo kërkimin e informacioneve, të cilat ndoshta e kanë humbur sensin nga ardhja e tyre me vonesë, nga mosangazhimi dhe kërkitimi i herë pas hershëm nga ana e çdo anëtari dhe mospasja dijëni nëse administrata e kreu, apo jo këtë detyrë. Në këto kushte, mendoj që është e domosdoshme që ky paragraf të shtohet edhe me fjalinë, në fund të fjalës kërkesës të shtohet “në mbledhjen vijuese të raportojë..”, pra administrata, “... të raportojë për zbatimin e detyrave të ngarkuara dhe kërkesave të lëna për zbatim. Pra, “... të raportojë për zbatimin e detyrave dhe kërkesave për informacion, të ngarkuara në mbledhjen pararendëse.”

Znj. I. Nano: Dakord. Propozimi i zonjës Vukaj. Kolegu Çelaj, kishit diçka dhe ju?

Z. A. Çela: Faleminderit! Unë mendoj që shkronja e pikës 2 të riformulohet në një mënyrë ndryshe dhe po e citoj: “T’i kërkojë informacion, dokumentacion dhe mbështetje...” dhe të hiqet pjesa “...si dhe të lerë detyra..” dhe më pas “sipas nevojave të administratës së KQZ-së e cila ka detyrim t’ju përgjigjet kërkesave dhe të verë në dispozicion fotokopje të çdo dokumentacioni që administrohet nga KQZ, sipas kërkesës. Mendoj që të hiqet pjesa “...si dhe të lerë detyra..”, për faktin se secili prej anëtarëve të Rregullatorit mund t’i lerë detyra të ndryshme administratës gjë që do ta çojë në konfuzion pjesën e administratës për këtë gjë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Znj. I. Nano: Ju propozoni vetëm të hiqet fjala "...si dhe të lerë detyra..". Propozim tjetër?

Z. M. Çakaj: Jo! Unë nuk kam një propozim tjetër, por mbështes propozimin e zonjës Vukaj. Në lidhje me propozimin e kolegut Çela, sjell në vëmendjen tonë që ligjvënësi në nenin 20, të Kodit Zgjedhor, ka ngarkuar dhe ka përcaktuar kompetencat e Komisionit Rregullator në lidhje me miratimin e akteve. Gjithashtu në nenet pararendëse të Kodit Zgjedhor, ligjvënësi ka përcaktuar që projektaktet për miratim, propozohen ose nga Komisioneri nëpërmjet administratës dhe në nenin 25, pika 12 me ndryshimet e reja të Kodit Zgjedhor të datës 26 korrik 2024, ka nominuar posaçërisht Komisionerin që të propozojë aktet për votimin nga jashtë. Thënë këtë, unë vlerësoj dhe gjykoj që procesi i normimit të akteve nga Komisioni Rregullator, nuk është një proces statik, pra ne vijmë në mbledhje miratojmë aktet. Sigurisht, ne diskutojmë, lemë detyra, kërkojmë informacion. Pra, në kuadër të krijimit të bindjes së brendshme tonin për të miratuar, ndryshuar, propozuar apo rrëzuar një akt, sigurisht që kjo është pjesë e së gjithës. Patjetër që është..., do të jetë në diskrecionin tonë që edhe të lemë detyra, në mënyrë që të kërkojmë informacion. Të kemi informacionin e duhur që normimi të jetë gjithpërfshirës, i plotë dhe sigurisht t'i shërbejë zgjedhësve shqiptarë. Kështu që, unë e gjej me vend prozimin nga ju zonja Kryetare e Rregullatorit që Komisioni Rregullator të ketë të drejtën t'i lerë detyra administratës së KQZ-së dhe sigurisht të kërkojë, jam 100% dakord me propozimin e zonjës Vukaj, që administrata pas detyrave, apo kërkesave të ndryshme të Komisionit Rregullator, të raportojë në lidhje me zbatimin e tyre. Theksoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një i gjithi. Secili., ligjvënësi e ka paraparë kur organizoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si një komision i përbërë nga tre organe drejtuese, të cilat kanë detyra të përcaktuara, por edhe njëkohësisht

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Çfarë do të ndodhë.., marr për analogji, çfarë do të ndodhë nëse KAS-i, organi tjetër drejtues i Komisionit Qendror, do t'i heqim të drejtën që t'i lerë detyra administratës? Atëherë KAS-i, praktikisht do të jetë në pamundësi vendimmarrje. Edhe në një situatë hipotetike, që ne do të ndodhemi në një situatë ngërçi, do të kemi nevojë për informacione shtesë, do të kemi nevojë për detyra të lëna administratës, për raportim e zbatimit të këtyre detyrave, që ne të marrim një vendimmarrje të plotë, objektive. Atëherë, nëse ne ia heqim këtë tagër vehtes, të drejtën e lënies së detyrave, ne do të jemi në vendimmarrje të cunguar, nuk do të kemi informacionin e plotë. Nuk do të kemi njohuritë e plota mbi ato çfarë kemi kërkuar, mbi detyrat e lëna? Kështu që unë vlerësoj se kjo tagër, kjo e drejtë do të duhet t'i jepet Komisionit Rregullator. Është normalisht një detyrim ligjor, në mënyrë që vendimmarrja jonë të jetë ligjore, e plotë, objektive dhe e pranuar nga të gjitha palët. Në çdo rast, ligjvënësi ka parashikuar që në çdo rast, në qoftë se njëra palë do të jetë e pakënaqur nga vendimmarrja e Komisionit Rregullator, atëherë ka të drejtën e ankimit brenda pesë ditëve në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës së Apelit. Kështu që, unë e gjej me vend propozimin tuaj dhe nuk vlerësoj se duhet të votojmë pro kërkesës për ngushtimin e tagrave të Komisionit Rregullator, as zgjerimit. Kjo është brenda kuadrit të vendimmarrjes sonë, brenda tagrave që na ka ngarkuar ligjvënësi. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zonja Vukaj, pastaj zoti Çaka!

Znj. H. Vukaj: Së pari, do të ndalesha tek inisiativa e zonjës Nano për të qenë propozuese në këtë akt, për ta përgëzuar që ka marrë nismën ta shprehë një të drejtë të pamohueshme tonën si organe vendimmarrëse të pavarura në këtë trupë. Secili nga ne, të nderuar kolegë, përbën organ përmes të cilit shpreh vullnet dhe vetëm

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

përmes këtij vullneti, aktet tona marrin jetë, ose kthehen të qenësishme për palët të përfshira në proces dhe për të gjithë shtetasit shqiptarë. Në këtë kuadër i nderuar zoti koleg, ju ndoshta se gjeni me vend duke dhënë argumentin e konfuzionit që mund t'i shkaktohet administratës. Kjo më duket pak absurde, se administrata është në funksion të të tre trupave të këtij institucioni, i cili pa këto tre trupa nuk mund të quhet institucion. Në këtë kuadër, kjo është detyra e administratës, të marrë detyra, të zbatojë detyrat dhe të përgjigjet për të gjitha kërkesat tona, me qëllim konsolidimin e akteve tona në emër të interesit publik. Në të kundërt çfarë do të konsiderohet kjo? Privilegj, apo cënueshmëri subjektive e administratës, e cila mund të preket nga lënia e detyrave? Kjo nuk është as përtej orarit, është gjatë angazhimit të punës së administratës. Është në funksion të procesit zgjedhor. Është në funksion të një organi të lartë drejtues, ashtu si paralelisht mund të jetë në funksion të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, apo të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, po kështu do të jetë dhe në funksion të Komisionit Rregullator. Ne nuk jemi persona të kontraktuar për të noterizuar akte të cilat na vijnë nga administrata, ose të propozuara kryesisht nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Ne këtu jemi për të folur dhe për të votuar në emër të interesit publik dhe bazuar në Kodin Zgjedhor dhe në të gjithë legjislacionin i cili tendon të rregullojë dhe të nxjerrë akte me një garanci të plotë juridike. Kështu që, unë personalisht nuk e gjej me vend propozimin e kolegut, edhe njëherë mbështes propozimin e zonjës Nano për këtë fjali dhe ritheksoj dhe njëherë domosdoshmërinë e shtimit në fund të paragrafit edhe të fjalisë që propozova më lart. Pasi personalisht më ndodhi të lija detyrën për të disatën herë, e të disatën herë dhe ato nuk përmbusheshin. Çfarë duhet të bëja unë? Të ankohesha për administratën? Ku?! Te kush?! Atëherë, duhet patjetër në formë të shprehur, meqenëse nuk ekziston ndërgjegjia që administrata të njeh një prej organeve drejtuese. Patjetër si domosdoshmëri, aq më tepër në vendimmarrjet

*Zbardhi materialin audio
Meritq DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

historike që na presin në aktet që kanë të bëjnë me implementimin e votimit nga jashtë të të gjithë emigrantëve nga jashtë me shtetësi shqiptare. Faleminderit, unë kaq kisha, shpresoj që kolegu edhe mund ta tërheqë propozimin e tij.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kryetare! Jam kryesisht dakord edhe me ato çfarë kolegët shprehën në lidhje me rëndësinë e Komisionit Rregullator dhe të drejtat që ka ky komision në krahasim edhe me strukturat e larta, dy organet e tjera. Absolutisht nuk ka ndonjë organ tjetër që mund të ketë epërsi, ose jo në këtë raport. Si e kuptova unë propozimin e kolegut Çela. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për detyra që absolutisht mund të lerë Komisioni Rregullator dhe t'i mohohen këto të drejta. Ky nen bën fjalë për të drejtat që ka secili prej anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe mesa kuptoj unë, të më korrigjojë nëse është kuptimi im i gabuar i asaj çfarë ai shprehu. Pra, nëse secili prej nesh është kuptimi, le detyra për administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund të ndodhë që këto detyra do të kenë përplasje të kërkesave, kjo mund të çonte në një situatë. Absolutisht që Komisioni Rregullator ka gjithë të drejtën për të lënë detyra administratës, por këtu thelbi, me sa kuptoj, bën fjalë që secili..., pra konfuzioni që mund të krijohet nëse secili prej ne të pestëve i lë nga një detyrë administratës për çështje të cilat mund të jenë përplasje me njëra-tjetrën. Ndërkohë për pjesën tjetër, absolutisht unë jam shumë dakord që informacioni të kërkohet, sepse është detyrimi i strukturave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke përfshirë dhe administratën, si dokumentacioni, si mbështetja, kështu që në vlerësimin tim, mendoj se propozimi i zotit Çela është me vend, faleminderit!

Znj. I. Nano: Po, zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Z. M. Çakaj: Kam dhe diçka tjetër! Meraku i kolegut Çaka lidhur me tejkalimin e diskrecionit tonë në lënien e detyrave administratës, e ka zgjidhur titulli i pikës 2, të nenit 5. Në pikën 2, të nenit 5 parashikohet që çdo anëtar dhe kryetari i Komisionit Rregullator, për ushtrimin e funksioneve të veta ka dhe këto të drejta, që do të thotë, kjo është në diskrecionin e funksionit të anëtarit të Komisionit Rregullator. Kjo është e mbyllur, e zgjidhur, e kemi ezauruar këtë pjesë. Në ushtrimin e funksionit të tij, dhe tagrave të tij në të cilën parashikohen nga neni 20 i Kodit Zgjedhor, krahas informacionit, dokumentacionit dhe mbështetjes së KQZ-së, ne kemi të drejtë dhe nuk po e kalojmë këtë në ushtrimin e funksionit tonë, që të lemë dhe detyra. Një rast hipotetik, ne i lemë detyrë administratës së KQZ-së që ta plotësojë relacionin. Nëse ne ia mbyllim, ia ngushtojmë, ia heqim kompetencat Komisionit Rregullator, puna jonë do të jetë e cunguar, relacioni do të jetë i paplotë. Detyrat mund të jenë të karakterit të paidentifikuar për momentin, por mund të lindë një nevojë. Dmth është gjithshka në ushtrim të funksionit tonë, nuk po e tejkalojmë kompetencën. Nuk mund të ngarkojmë detyra të karakterit ekzekutiv. Edhe nëse ndonjë prej nesh mund të ngarkojë detyra të karakterit ekzekutiv, apo detyra të karakterit të kompetencave të KAS-it, sigurisht administrata nuk është e detyruar ta zbatojë këtë. Ne e kemi thelbësisht për ushtrimin e funksioneve tona. Është e qartë këtu, në rregulloren tonë të miratuar. Kështu që besoj se shqetësimi juaj është i ezauruar në pikën 2, në titullin e kësaj. Nuk mund ta tejkalojmë natyrën e detyrave, por dhe të mos kemi të drejtë të lemë detyra, pastaj çfarë? Ne kthehemi në instuticion noterie...

Z. D. Çaka: Si Rregullator, po!

Z. M. Çakaj: Si Rregullator e kemi këtu! Çdo anëtar dhe kryetari i Komisionit Rregullator për ushtrimin e funksioneve të veta ka dhe këto të drejta. Ne jemi organ

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

drejtues, do të lemë dhe detyra. Po i tejkaluam, po atëherë është në diskrecion së pari, të administratës ta vlerësojë dhe së dyti, të organeve të tjera. Nëse ne ndërhyjmë në një nga kompetencat e organeve të tjera. Unë besoj se është e qartë, e gjej mëse me vend t'i japim këtë të drejtë vetes, në ushtrimin e funksioneve tona.


Znj. H. Vukaj: Kolegu Çaka, vetëm një shtesë, në qoftë se ju ende mendoni, pas katër viteve që nuk përbëni përfaqësuesin individual sipas Kodit të Procedurës Administrative, të quajturin organ, pra shprehjes së vullnetit, kjo atëherë le vend për të menduar që ne, deri tani paskemi vepruar si administratë e KQZ-së, jo si autoritete të pavarura. Si autoritete të pavarura, ne absolutisht edhe në merakun tuaj se mos i krijohet ngarkesë të përsëritur administratës, ne kemi rakorduar me njëri-tjetrin me zë dhe figurë këtu, që ne nuk kemi kërkuar kërkesa as të tepruara, as të mbivendosura me njëri-tjetrin. Secili ka një optikë ndryshe për vendimmarrjen, ndryshe për logjikën e ecjes së çdo propozimi dhe në këtë kuadër, na takon që të lemë detyra pa diskutim administratës. Administrata është e detyruar, brenda kompetencave tona që të na përgjigjet në kohë sipas përcaktimeve në Kodin Etik, apo në rregulloren tonë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kalojmë në votim. Lidhur me këtë pikë kemi dy propozime. Propozimi i zonjës Vukaj: Të shtohet në fund "Raportimi për çdo detyrë të dhënë dhe në mbledhjen vijuese administrata të raportojë për zbatimin e detyrave dhe kërkesave për informacion të ngarkuara në mbledhjen pararendëse". Kemi pastaj dhe propozimin e zotit Çela. Kështu që fillojmë votojmë propozimet sipas rradhës që janë bërë në mbledhje.

Kush është dakord me propozimin e zonjës Vukaj për një shtesë?

Pro: 3 (znj. I. Nano, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Kundër: 2 (z. A. Çela, z. A. Çaka)

Nuk miratohet!

Kemi propozimin e zotit Çela..,

Znj. H. Vukaj: Ndoshta kjo është marrja e fjalës në kushtet e.., nuk kërkoni raportim ju kolegë kur lini një detyrë, apo një marrje informacioni? E lini në hava këtë gjë? Më falni, sepse kjo është shumë e rëndësishme dhe duhet cekur, madje duhet trajtuar dhe analizuar.


Z. D. Çaka: Duke qenë vazhdim i të njejtit propozim që është bërë në fillim dhe propozimi juaj lidhet me një informacion që do të japë më pas KQZ-ja, pra administrata po për detyrat. Është pikërisht i njejtë togfjalësh si në propozimin tuaj dhe të zonjës Nano nuk shkon në vlerësimin tonë me situatën.

Znj. H. Vukaj: Dakord! Po në rastin kur unë të le detyrë dhe detyra nuk përmbushet në kohë nga administrata? Kjo do të bëjë që unë të mos miratoj aktin dhe kolegu, apo ndonjë koleg tjetër të refuzojë miratimin e aktit i cili mund të jetë thelbësor edhe për procesin e votës nga jashtë. Si i bie? Do të bojkotojmë procesin se administrata në mendimin, apo optikën tuaj duhet të mbetet e paangazhuar dhe pa (në thonjëza) “pa e obliguar” nga anëtarët e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë?

Z. M. Çakaj: Kjo do të çojë në ngërç në miratimin e aktit se nuk do të kesh detyra të bëra! Në detyrat e lëna nuk do të kesh informacion, nuk do të kesh kërkesa...

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj, vetëm një moment ju lutem! Me cilësinë e propozuesit të aktit së pari, unë do të doja... unë po drejtoj mbledhjen. Votova një propozim me tre

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

vota pro, dy kundër nuk u miratua. Sapo të marr rradhën të votoj propozimin tjetër, ju vijoni dhe kërkoni argumenta për votimin kundër të të dy kolegëve. Kështu që jemi në kushtet që të votojmë dhe një propozim tjetër, mund të miratohet, mund të mos miratohet! Nga ana tjetër kemi dhe një propozim tjetër të ardhur me shkrim, mund të miratohet, mund të mos miratohet! Këtë jam duke thënë. Pra, si procedurë, mbaruam një propozim, u diskutua propozimi, u votua. Tani kemi një propozim tjetër për të votuar!

Znj. H. Vukaj: Jeni korrekte e nderuar zonjë, por kjo është shumë e rëndësishme, ndaj publiku duhet të dëgjojë argumentat të cilat i japin propozimit vlerë, ose nuk i japin vlerë dhe unë mendoj se qëndron dhe kam rastin tim eksplicit. Kur unë i drejtohem administratës, s'po marr se çfarë kërkesash kam bërë, por që më është dashur t'i përsëris nga dy-tre herë këtu në sallë që të realizoheshin. Po marr rastin e fundit për zgjedhjet e Himarës. I drejtohem administratës që t'i drejtojë një shkresë këtu në mbledhje, jeni dëshmitarë dhe ju, një kërkesë që t'i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të thesarit, etj., etj., për emrat e punonjësve të Bashkisë Vlorë, e më gjerë.., Sarandë dhe preferkturës. Në këtë kuadër informacioni erdhi pas disa ditëve. Unë i le detyrë administratës që të fillonte analizimin dhe vlerësimin e gjithë elementëve të rrishtit duke pasur këtu dhe materialet e auditit teknikien dhe të bënte paralelizmin dhe të zbatonte detyrën time. E di çfarë përgjigje më erdhi? Administrata nuk e vlerëson që këtu ka elementë rrishtit. Kjo është e rëndë! Unë lashë një angazhim, lashë një detyrë që nuk u zbatua. Çfarë duhet të bëj unë? Të dal në media dhe të them që ky institucion është i pabesueshëm? Ky institucion është i njëanëshëm? Ky institucion është subjektiv?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Znj. I. Nano: Zonja Vukaj! Për sa të dy kolegët që folën më tepër, gjithshka u diskutua në raport me kompetencën tonë. Tani nuk po i futem diskutimeve të tjera nëse duhet të bëjë një analizë të riskut administrata, është në kompetencën tonë për të miratuar akte me karakter normativ. Gjithësesi kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çela për ndryshimet në shkronjën “a”, të pikës 2.

Pro: 2 (z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 3 (znj. I. Nano, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Nuk miratohet!

Atëherë do të na duhet të votojmë propozimin e ardhur paraprakisht me shkrim.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Nuk miratohet!

Kjo pikë, pra shkronja “a” e pikës 2 nuk miratohet dhe mbetet siç ka qenë në rregullore. Më lejoni ta lexoj “Çdo anëtar dhe kryetar i Komisionit Rregullator për ushtrimin e funksioneve të veta ka këto të drejta...” dhe jemi te shkronja “a. T”i kërkojë çdo informacion, dokumentacion dhe mbështetje administratës së KQZ-së, e cila ka detyrim të verë në dispozicion sipas kërkesës, fotokopje të çdo dokumentacioni të depozituar në KQZ”. Pra, kjo pikë nuk miratohet. Kalojmë në pikën tjetër.

Pas shkronjës “b” të pikës 2 shtohet shkronja “b/1” me këtë përmbajtje:

“b/1. Të kërkojë praninë në mbledhjet e Rregullatorit të përfaqësuesve të subjekteve zgjedhorë, organizatave joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatave ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara dhe me përvojë në fushën e zgjedhjeve si dhe çdo subjekt që ka interes të ligjshëm për projektaktin që shqyrtohet.”.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Kolegë diskutim për këtë projektakt, ndonjë propozim për ndryshim?

Znj. H. Vukaj: Një shtesë në fund të kësaj fjalie, “ose mendimin e tyre paraprak”.

Znj. I. Nano: Propozim tjetër për këtë pikë? Nuk ka! Kalojmë në votimin e kësaj pike me propozimin e zonjës Vukaj për të shtuar togfjalëshin, “ose mendimin e tyre paraprak”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S’ka!

Miratohet me pesë vota pro!

Kalojmë në pikën 2. Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ.”. Në rregulloren që kemi aktualisht në fuqi ka qenë “Komisioni Rregullator”, tani është “kryetari dhe çdo anëtar”. Diskutime, apo të kalojmë në votim për këtë nen?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S’ka!

Me pesë vota pro miratohet!

Pika tjetër, në nenin 17, pika 3 ndryshohet si më poshtë.

Aktualisht propozimi është ky!

“3. Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

projektaktin që shqyrtohet.”. Si propozuese, por dhe me një sugjerim të koleges Vukaj, pak më herët, më lejoni ta riformuloj propozimin tim.

“Në çdo rast, kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë në mbledhje për shpjegime edhe zyrtarë të tjerë të KQZ-së..” dhe vijojmë “që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet. Pra, të shtojmë fjalën “në mbledhje”, por “edhe zyrtarë”, se normalisht ne kemi zyrtarë të administratës të pranishëm në çdo mbledhje, edhe të tjerë. Kemi diskutime për këtë propozim?

Z. M. Çakaj: Jo, kam unë një shtesë, një propozim!

Znj. I. Nano: Dakord, zoti Çakaj!


Z. M. Çakaj: Në nenin 17, pas pikës 3, të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje, “Në rastet kur propozuesi i projektaktit do të jetë Komisioneri, atëherë ai do të propozojë personalisht aktin përpara organit Rregullator”. Siç e ka ngarkuar.., kjo nuk është propozim. Propozimi është “Në rastet kur në përputhje me Kodin Zgjedhor, propozuesi i aktit është ngarkuar të jetë Komisioneri, ai është i detyruar.., ose ai do të bëjë propozimin, do të relatojë aktin përpara Komisionit Rregullator”. Marr shkas për propozimin...

Znj. I. Nano: Më fal zoti Çakaj, është propozim pas pikës 3..,

Z. M. Çakaj: Të shtohet pika 4.

Znj. I. Nano: Dakord, pika 4, po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Z. M. Çakaj: Marr shkas nga ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, në datë 26 korrik 2024 dhe posaçërisht për procesin shumë të rëndësishëm të votimit për shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit, ligjvënësi ka ngarkuar në mënyrë të posaçme Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të propozojë aktet përpara Komisionit Rregullator. Në rastin konkret, duke qenë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë kontakte, ka zhvilluar një sërë takimesh edhe me përfaqësuesit politike, edhe me komisionet e ndryshme të reformës zgjedhore të Kovendit të Shqipërisë, ka organizuar takime informuese edhe me organizatat partnere OSBE, ODIHR ose me organizata jofitimprurëse të cilat e zhvillojnë aktivitetin dhe veprimtarinë e tyre në fushën zgjedhore. Pra, unë gjykoj dhe vlerësoj, përpos faktit që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është ngarkuar nga ligjvënësi të propozojë këto akte, në ndryshim nga neni 20 i Kodit Zgjedhor, ku parashikohet Komisioneri nëpërmjet administratës. Në nenin 25, pika 12 është ngarkuar në mënyrë të posaçme Komisioneri të hartojë dhe të propozojë këto akte. Pra, propozimi im ka të bëjë me materializimin e vullnetit të ligjvënësit. E gjej me vend që ta votojmë në rregulloren tonë.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj. Kemi propozime të tjera për këtë pikë? Atëherë kemi së pari, të shtojmë fjalët “në mbledhje”, fjalën “edhe..”. Po e riformuloj. Në çdo rast kryetari dhe çdo anëtar i Komisionit Rregullator mund të thërrasë për shpjegime në mbledhje edhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së që kanë lidhje me projektaktin që shqyrtohet. Ta votojmë se janë dy shtesa.


Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Votojmë dhe propozimin e zotit Çakaj, i cili kërkoi që në nenin 17, pas pikës 3, të shtohet pika 4, me këtë përmbajtje “në rastet kur sipas Kodit Zgjedhor propozuesi është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, atëherë ai duhet të relatojë aktin para Komisionit Rregullator”. Jam korrekte me propozimin? Kalojmë në votim!

Kush është dakord kolegë?

***Pro:** 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)*

***Kundër:** 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)*

Me dy vota pro, e tre vota kundër nuk miratohet ky propozim i zotit Çakaj!

Kalojmë në pikën e rradhës.

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

Forma e aktit


Akti i miratuar nga Komisioni Rregullator është i shkruar dhe përmban:

- a. Stemën e Republikës së Shqipërisë;
- b. Emrin e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- c. Logon e institucionit (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve);
- d. Emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator);
- e. Titullin e aktit;
- f. Preambulën e aktit ku përfshihen dispozitat e kompetencës së nxjerrjes së aktit, dispozitat autorizuese për nxjerrjen e aktit si dhe propozuesi i aktit;
- g. Përmbajtjen e aktit;
- h. Emrat e anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje;
- i. Mënyrën e votimit të secilit anëtar (pro/kundër);
- j. Numrin, datën dhe orën e miratimit.

Pika 2. Akti nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhje, pasi të kenë verifikuar përmbushjen e vullnetit të tyre të shprehur me votë”.

Kolegë?! Po zoti Çaka!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Z. D. Çaka: Faleminderit! Kam vetëm një sugjerim mos duhet të bëjmë një rregullim, sepse te ky propozimi juaj thuhet në pikën “b” emri i institucionit në kllapa (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve), kur themi logon përsëri (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve). Mos duhet ta cilësojmë këtu logon e institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, se mos duket sikur përdoret dy herë i njëjti togfjalësh? Mbase e kuptoj unë gabim po thjesht është paraprake kjo si...

Znj. I. Nano: Po nisem nga cilësia e propozuesit. “Në çdo akt do të ishte emri i institucionit, logo e institucionit që në fakt përputhen në këtë rast, por kjo është vendosur dhe në kllapa se kush është institucioni për ta dalluar nga organi se kush e miraton aktin, që është Komisioni Rregullator më poshtë. Mund të jetë emrin dhe logon e institucionit dhe vendosim në kllapa (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve). Kjo është e institucionit, jo e organit.

Z. D. Çaka: Unë kisha këtë sugjerim, emri i institucionit, patjetër që është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kur themi logon e institucionit e... se duket sikur e kemi dy herë, sepse përdoret njëjta logjikë.

Znj. I. Nano: Po pra, të mos përmendet më në kllapa sepse...

Z. D. Çaka: Ideja është që te pika “c”, të mos përdoret më termi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, se është e kuptueshme,

Znj. I. Nano: Dakord, një propozim...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Z. D. Çaka: Gjithshka është e kuptueshme... Ose lerini dhe kështu..., jo jo nuk është..., thjesht është..., edhe kështu mund ta lemë.

Znj. I. Nano: Ndonjë propozim tjetër për këtë nen kolegë? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në vështirësi të të gjithë pikave, përveç përmbajtjes së aktit që në dukje të parë, presupozohet që e përfshin, por për shkak të rëndësisë që ka, unë mendoj që pas kësaj germe të shtojmë një germë “h” dhe më pas germat të rirenditen dhe të rishkruhen, duke shtuar dhe ngarkimin e organit/organeve të autorizuara nga ligji, për shkak se vendimmarrja tani do të jetë intensive dhe që përfshin shumë aktorë, shumë organe. Në këto kushte mendoj se duhet shtuar organet të autorizuara nga ligji, që kanë kompetencën të përfshihen në të.

Znj. I. Nano: Jo domosdoshmërisht të ngarkuara nga ligji, se i bie që..., po për ato që ngarkojmë ne me detyra nga aktet tona për këtë. Pra, në përmbajtje të aktit, pasi mbaron përmbajtja normative e aktit të kemi dhe ngarkimin me detyra të organit/organeve që ngarkohen me detyra për zbatimin e aktit. Ndonjë propozim tjetër për këtë nen? Atëherë, pas germës “g”. “Përmbajtja e aktit”, të shtohet germa “h”. Organi/organet e ngarkuara me zbatimin e aktit”. Atëherë nuk ka propozime të tjera për këtë pikë, kalojmë në votimin e propozimit të zonjës Vukaj.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)


Kundër: S’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2, e nenit 34 shfuqizohet.

Kush është dakord kolegë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 27.09.2024*

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Dhe kreu i fundit,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Me 3 vota pro dhe 2 kundër.. jeni kundër për këtë pikën e fundit?!

Z. M. Çakaj: Po jemi kundër!

Znj. I. Nano: Dakord! Kalojmë në votimin në tërësi të aktit, duke qenë se nga një propozim kemi pas disa ndryshime, një pjesë janë miratuar dhe një pjesë jo.

Kush është dakord në tërësi me projektaktin?

Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. A. Çaka)

Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Akti nuk miratohet, meqenëse nuk u miratua në tërësi.

Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 09

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

